




Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	13.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSJK	6058/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.888/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.888/2021 të datës 27.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr." Qamil Zeqiri" Nr.12, Vushtrri, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.888/2021 të datës 27.10.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi kandidat për shërbim civil, me datë 27.10.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit KA.nr.50/2021 të datës 29.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijen e Ankesave, me datë 04.11.2021 ka përcjellë kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 17.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova: Ankesën me numër protokollit 5181/2021 e datës 27.10.21 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës

04.11.2021; Vendimin me nr. 01/1569 të datës 29.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Certifikatë e datës 10.06.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 17.11.2021; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare me Nr.03/1406 të datës 20.08.2021; Deklaratën për mosekzistimin e konfliktit të interesave për të datës 23.07.2021; Deklaratën për mosekzistimin e konfliktit të interesave për V.F. të datës 23.07.2021; Deklaratën për mosekzistimin e konfliktit të interesave për E.P. të datës 23.07.2021; Deklaratën për mosekzistimin e konfliktit të interesave për të datës 23.07.2021; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave për nuk ka datë; Raportin final lidhur me rekomandimet e Komisioni rekrutues; Propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 20.08.2021; Përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 23.07.2021; Përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 16.08.2021; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Udhëzuesin për testin me shkrim i kandidatës i datës 30.07.2021; Vlerësimet e testit me shkrim të kandidatës të datës 30.07.2021; Vlerësimet e testit me gojë të kandidatës të datës 15.08.2021; Vlerësimin e testit me shkrim i kandidatës i datës 30.07.2021; Vlerësimin e testit me gojë të datës 13.08.2021; Vlerësimin e testit me shkrim i kandidatës të datës 30.07.2021; Vlerësimin e testit me gojë të datës 14.08.2021; Kërkesën për punësim të kandidatës të datës 03.06.2021; Referencën e datës 03.06.2021; Rekomandimin i datës 31.05.2021; Kontratën Punës për Kohë të Caktuar të të datës 08.11.2019 deri 31.12.2019; Vërtetimin e datës 22.04.2020; Akt Emërimin e datës 10.06.2020; Vërtetimin e datës 24.05.2021; Certifikatën e datës 30.10.2016; Certifikatën e datës 28.10.2017; Certifikatën nga Youth Activism Center e muajit dhjetor 2015; Certifikatën e datës 27.10.2018; Certifikatën e datës 30.11.2018; Certifikatën e datës 17.12.2018; Certifikatën e datës 10.06.2021; Testin me shkrim të kandidatës me Nr.561 Diplomën me Nr.7004 të datës 10.09.2020; Ankesën drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 09.09.2021; Flete kthimin e Postës të datës 04.10.2021; Vlerësimet e testit me shkrim të kandidatit të datës 30.07.2021; Vlerësimet e testit me gojë të kandidatit të datës 13.08.2021; Udhëzuesin për testin me shkrim i kandidatit i datës 30.07.2021; Testin me shkrim me Nr.547 të kandidatit E.XH.; Kërkesën për punësim të kandidatit të datës 26.05.2021; Diplomën me Nr.6751 të datës 23.12.2019; Vërtetimin me Nr. 135 të datës 18.01.2021; Pasqyrën e TRUST për nga data 01.08.2002 deri 20.05.2021; Kërkesën për punësim të kandidatit datës 28.05.2021; E-mailin nga C.Z. për të datës 26.11.2021; E-mailin nga për të datës 26.11.2021; Plikon me nr. 03/1786 të datës 16.11.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ekziston baza ligjore që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, për katër (4) pozita, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Organi i punësimit me datë 20.08.2021, ka publikuar njoftimin lidhur përzgjedhjen përfundimtar të kandidateve për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega

Vushtrri, sipas të cilit njoftim është poentuar si kandidatja e parë me gjithsej 437.75 pikë, si kandidatja e dytë me gjithsej 404.5 pikë, kandidati i tretë me gjithsej 394.25 pikë dhe si kandidatja e katër me gjithsej 392.5 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidateve, ankuesi është poentuar me gjithsej 329 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me Njoftimin e datës 20.08.2021, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare, me datë 09.09.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.nr.50/2021 të datës 29.09.2021 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 09.09.2021 të parashtruar nga ankuesi dhe ka lenë në fuqi listën përfundimtare lidhur me përzgjedhje e kandidateve të suksesshëm.

Pas pranimit të Vendimit KA.nr.50/2021 të datës 29.09.2021 të KZKA/KGJK, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve procedurave të rekrutimit lidhur me pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, me pretendimin ankimor se kandidatja e përzgjedhur nuk i plotëson kushtin e përvojës së punës prej një (1) viti, siç kërkohet në konkurs.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se edhe kandidati ka aplikuar në Konkursin e datës 20.05.2021 për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, dhe se i njëjti me datë 27.10.2021 ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, duke kundërshtuar përzgjedhjen e kandidates fituese. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e vendosjes së ankesës së me Vendimin A.nr.889/2021 të datës 10.12.2021 ka refuzuar ankesën si të pa bazuar dhe ka lenë në fuqi njoftimin e datës 20.08.2021 lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidateve për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Andaj, bazuar në këtë konstatim si dhe në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", Kolegji ka vendosur që të përfundoj procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.888/2021 të datës 27.10.2021, pasi që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.888/2021

Çlirim ZEKA

Çlirim ZEKA
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.